

së Epërme/Gornja Lapaştica. Shefkija me familjarë vendosën ta braktisnin fshatin. Dolën në rrugë dhe në ato çaste tri vajzat e Shefkijes, njëra prej të cilave i kishte vetëm tre vjet, u ndan nga e ëma dhe bënë përpjekje që të shpëtonin nga plumbat. Shefkija me vajzën Elhemen dhe vjehrrën shkuan te kushëri i cili banonte afër fabrikës *Javor*, në të njëjtën rrugë. Aty ajo i la dhe u kthye për ti kërkuar vajzat e saj. Nuk u kthye më. Një ditë më vonë, vëllai i Latifit, Qerkini, e ka gjetur trupin e pajetë të Shefkijes pranë kapisë së shtëpisë së babait të Shefkijes, Shaqir Kodraliu, afro 400 metra larg shtëpisë së familjes Salihu [Podujevë/Podujevo]. Familjarët e kanë paraqitur rastin e vrasjes në misionin e OSBE-së në Prishtinë/Priştina, me ndihmën e së cilës trupi i Shefkijes u bart dhe u varros. Fëmijët kanë dëgjuar se nënën e tyre e kishin vrrarë me një plumb snajperi në kokë. E kanë varrosur më 26.12.1998 në varrezat e qytetit të Podujevës/Podujevo.

**Burimet:** deklarata E.S, FDH-4065; J. Osmani, *Krimet...*, II, 123.

### Behxhet (Ramiz) Maqani

(28.03.1967, shqiptar nga Podujeva/Podujevo, tre fëmijë)

Behxheti punonte si kamerier në restorantin e *Albpetrollit* në **Sekiraqë/Sekirača**, ndërkaq me familjen e vet jetonte në Podujevë/Podujevo. Në orët e hershme të mëngjesit, më **24.12.1998**, Bexheti shkoi në punë. Rreth orës 9:00, në qytet u dëgjuan krismat e shumta. Bashkëshortja e Bexhetit Lumnia ka dëgjuar në radio *Deutsche Welle* rreth orës 13:00, se e kishin vrrarë një burrë në afërsi të rrugës Podujevë/Podujevo–Prishtinë/Priştina. Më vonë, Lumnia ka mësuar se Bexheti ishte nisur në shtëpi përmes arëve dhe se e kishin vrrarë pranë rrugës për Prishtinë/Priştina. Familjarët e kanë varrosur Bexhetin më 25.12.1998 në varrezat e Podujevës/Podujevo.

**Burimi:** deklarata L.K.M, FDH-12549.

### Ismet (Nurif) Dërguti

(2.12.1971, shqiptar nga Podujeva/Podujevo, punëtor, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

### Miftar (Arip) Zejnullahu

(11.05.1974, shqiptar nga Podujeva/Podujevo, punëtor, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

### Lulzim (Jakup) Jashari

(17.06.1975, shqiptar nga Podujeva/Podujevo, student, pjesëtar i UÇK-së)

### Skënder (Rahman) Zejnullahu

(12.03.1976, shqiptar nga Podujeva/Podujevo, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Ismeti, Miftari, Skënderi dhe Lulzimi kanë qenë pjesëtarë të njësitit të UÇK-së, i cili vepronte në Zonën Operative të Llapit/Lap. Ismeti ka qenë komandant i njësitit. Në datën **24.12.1998**, gjatë betejës ndërmjet forcave të UÇK-së dhe atyre serbe në fshatrat përreth Podujevës/Podujevo, Ismeti, Miftari, Skënderi dhe Lulzimi gjendeshin te pozicionet e UÇK-së në afërsi të qytetit, jo larg tjegullores [Obra-**nçë/Obbrandža**]. Që të katër kanë rënë në këto luftime. Vetëm pas disa ditësh, bashkëluftëtarët e tyre i kanë bartur trupat e të vrrarëve në xhami në Llapashticën e Epërme/Gornja Lapaştica. Familjet i kanë marrë trupat më 30.12.1998. Lulzimin e kanë varrosur po atë ditë në fshatin e tij të lindjes së Batllavës/Batlava, përderisa Miftari, Skënderi dhe Ismeti u varrosën më 31.12.1998 në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Podujevë/Podujevo.

**Burimet:** deklarata P.J, FDH-11784; deklarata S.H, FDH-35230; deklarata J.Z, FDH-11744; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHF DUÇK, *Feniksët...7*, 204.

### Milovan (Boško) Radojević

(28.06.1925, serb nga Obrança/Obbrandža, komuna e Podujevës/Podujevo, bujk, shtatë fëmijë)

Milovani i moshëthyer jetonte me bashkëshorten Milken dhe djalin Milivojen në **Obrança/Obbrandža**. Situata e qetë mbizotëronte në fshat deri në muajin dhjetor të vitit 1998, kur UÇK-ja u pozicionua në istikamet në afërsi të shtëpisë së tyre. Në mëngjesin e datës **26.12.1998**, nga ora 10:00, pranë shtëpisë